

REZOLUTË
PËR NDËRHYRJET E HUAJA NË PROCESET ZGJEDHORE DHE
DEZINFORMIMIN NË PROCESET DEMOKRATIKE KOMBËTARE

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke pasur parasysh detyrimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; anëtarësimi në NATO; “Strategjia e Sigurisë Kombëtare”; “Strategjia e mbrojtjes kibernetike”; “Agjenda digjitale e Shqipërisë 2014–2020”; “Dokumenti i Politikave për Sigurinë Kibernetike për vitet 2015–2017”;

- Duke marrë në konsideratë rezolutën e miratuar nga Parlamenti Evropian, më 10 tetor 2019 mbi “Ndërhyrjen e huaj në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike”, si dhe instrumentet e miratuara nga BE-ja në funksion të parandalimit dhe mbrojtjes ndaj luftës hibride dhe fenomenit të dezinformimit;

- Duke pasur parasysh që ndërlidhja globale e njerëzve dhe ekonomive me instrumente digjitale dhe teknologji të reja është përdorur në mënyrë të koordinuar nga aktorët shtetërorë dhe joshetërorë për të arritur objektiva specifike për të ndikuar në jetën politike dhe proceset vendimmarrëse;

- Duke pasur parasysh që media dhe veçanërisht platformat sociale, lehtësisht mund të shfrytëzohen për të përhapur dezinformimin, i cili përbën një formë kërcënimi në zhvillim që mund të cenojë rendin dhe sigurinë publike;

Referuar:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe konkretisht neneve 1, 2, 3, 5, 15, 22, 23 dhe 45;
- Paktit Ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike, të 16 dhjetorit 1966, dhe konkretisht neneve 2, 17, 19, 20 dhe 25;

- Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, veçanërisht neneve 8, 9, 10, 11, 13, 16 dhe 17 të saj, dhe Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, veçanërisht nenit 3 të saj;

Ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”; ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, të ndryshuar; ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar; ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;

Rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës nr. 2255 të 2019-s mbi “Shërbimin publik të mediave në kontekstin e dezinformimit dhe propagandës”;

Në kushtet kur:

a) tentativa nga aktorë të huaj shtetërorë dhe joshetërorë për të ndikuar në vendimmarrjen në Shqipëri apo për të ushtruar presion mbi vlerat demokratike, të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut, solidaritetit dhe barazisë me mjete të ndërhyrjes keqdashëse është një prirje mbarëbotërore;¹

b) ndërhyrja e huaj mund të shfaqet në forma të ndryshme, të cilat përfshijnë fushatat e dezinformimit në mediat sociale, me synim formësimin e opinionin publik; sulmet kibernetike, të cilat synojnë proceset zgjedhore dhe ndikimin në to; si dhe mbështetja e drejtpërdrejtë dhe jo e drejtpërdrejtë financiare e aktorëve politikë;

c) fushatat e dezinformimit rus përbëjnë burimin kryesor nga i cili buron dezinformimi në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në Evropë e më gjerë;²

¹ Paragrafët “a” dhe “b”, të kësaj rezolute, i referohen rezolutës së Parlamentit Evropian, datë 10.10.2019, “*Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes*”, përkatësisht shkronjës A dhe B të saj, P9_TA-PROV(2019)0031.

² Paragrafi “c”, i kësaj rezolute, i referohet rezolutës së Parlamentit Evropian, datë 10.10.2019, “*Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes*”, përkatësisht shkronjës E të saj, P9_TA-PROV(2019)0031.

ç) aktorët shtetërorë dhe joshetërorë nga vendet e tjera, përpos atij rus, janë të përfshirë në ndërhyrje dashakeqe në debate publike të vendit tonë;

d) rezoluta e miratuar nga Parlamenti Evropian, më 10 tetor 2019 mbi “Ndërhyrjen e huaj në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”, si dhe rezoluta e 23 nëntorit 2016 mbi “Komunikimin strategjik të BE-së për t’iu kundërvënë propagandës së aktorëve të tretë”,³ evidentojnë nevojën për një përpjekje të bashkërenduar në përballimin e këtyre fenomeneve në hapësirën e demokracive evropiane, si dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në vendet anëtare të BE-së, “hetime të ndryshme kanë treguar që rregullat e rëndësishme zgjedhore janë shkelur ose anashkaluar, veçanërisht dispozitat ekzistuese për transparencën e financimit të fushatës, me pretendime për shpenzime politike nga organizata jofitimprurëse me burime të ardhura nga vende të treta, veçanërisht nga Rusia”⁴ vëren me shqetësim Parlamenti Evropian;

dh) zgjedhjet e përgjithshme në Shqipëri do të zhvillohen në vitin 2021.

Kuvendi i Shqipërisë:

1. Thekson se liria e fjalës dhe e shprehjes, mbrojtja e të dhënave personale dhe e pluralizmit të mediave burojnë nga Kushtetuta e Shqipërisë si gur themeli i shoqërive demokratike, të cilat përbëjnë njëkohësisht angazhimin parësor të institucioneve të shtetit shqiptar për mbrojtjen dhe gëzimin e këtyre të drejtave.

2. Konsideron të nevojshëm nga ana e institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, si dhe atyre të pavarura vlerësimin mbi mjedisin e sigurisë, kuadrin ligjor, kapacitetet analitike dhe operacionale të strukturave që lidhen me evidentimin, parandalimin dhe reagimin ndaj rrezikut që vjen nga ndërhyrjet e huaja në procesin zgjedhor, financimet, sulmet hibride dhe dezinformimin, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

3. Rithekson se ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore minojnë të drejtën e shtetasve për të thënë fjalën e tyre në qeverisjen e vendit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur, siç parashikohet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe se një ndërhyrje e tillë nga shtetet e tjera përbën shkelje të parimeve bazë të së drejtës ndërkombëtare, edhe kur nuk ka përdorim të forcës ushtarake, kërcënim për integritetin territorial apo kërcënim për pavarësinë politike.⁵

4. Inkurajon Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore që të adresojë transparencën dhe auditimin e financimeve të partive politike, përfshirë financimet e huaja në fushata zgjedhore apo gjatë ushtrimit të veprimtarisë politike.

5. Inkurajon institucionet përgjegjëse të përfshijnë në kurrikulat e tyre mësimore edukimin mediatik në kuadër të masave kundër dezinformimit, në përputhje me standardet e BE-së, KE-së dhe UNESCO-s, si dhe të zhvillojnë fushata informuese të synuara me segmente të caktuara të popullatës që janë më të prekshme ndaj dezinformimit.

6. U kërkon institucioneve përgjegjëse të vlerësojnë ndërhyrjet e mundshme në legjislacion, marrjen e masave ligjore dhe administrative, si dhe të ndërveprojnë me platformat e mediave sociale, me qëllim të etiketimit sistematik të përmbajtjes, rishikimin e algoritmeve, në mënyrë që t’i bëjnë ato sa më të paanshëm që të jetë e mundur, dhe mbylljen e llogarive të personave që merren me veprimtari të paligjshme dhe që synojnë prishjen e proceseve demokratike ose nxitjen e gjuhës së urrejtjes, duke mos kompromentuar lirinë e shprehjes.

7. U kërkon Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Sigurisë Kibernetike, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetit të Medias Audiovizive, Autoritetit Kombëtar për

³ Referuar rezolutës së Parlamentit Evropian, datë 23.11.2016, “*EU strategic communication to counteract propaganda against it by third parties*” (2016/2030(INI))

⁴ Paragrafi “d” i kësaj rezolute i referohet rezolutës së Parlamentit Evropian, datë 10.10.2019, “*Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes*”, përkatësisht shkronjës L të saj, P9_TA-PROV(2019)0031.

⁵ Pikat 3, 5 dhe 6, të kësaj rezolute, i referohen Rezolutës së Parlamentit Evropian, datë 10.10.2019, “*Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes*”, përkatësisht në pikat 3, 15 dhe 30 të saj, P9_TA-PROV(2019)0031.

Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, si dhe Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, që të paraqesin një raport vjetor mbi sfidat dhe kërcënimet e evidentuara objekt i kësaj rezolute.

8. Vëren me shqetësim se Bashkimi Evropian e paraqet fenomenin e dezinformimit një prirje në rritje në shtetet anëtare të saj dhe dënon veprimet agresive të aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë në vendet e Ballkanit Perëndimor.⁶

9. Beson se këto kërcënime, për shkak të rrezikut që i sjellin demokracisë, nuk mund të adresohen vetëm nga autoritetet kombëtare që punojnë në izolim dhe as nga vetërregullimi i sektorit privat, por lypset një qasje e koordinuar në shumë nivele, me shumë palë të interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n, SHBA-në, BE-në dhe OSBE-në.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 5.12.2019.

⁶ Pika 8 e kësaj rezolute i referohet Rezolutës së Parlamentit Evropian datë 10.10.2019, “*Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes*”, përkatësisht në pikat 9 dhe 10 të saj, P9_TA-PROV(2019)0031.